
AKT THEMELIMI

"INTERNATIONAL TECHNOLOGIES HOLDING" SHPK

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do të jetë "INTERNATIONAL TECHNOLOGIES HOLDING" SHPK, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

2. Ortaku i vetëm i shoqërisë

Ortak i Vetëm i shoqërisë është: **Z. QAZIM BOJA**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 09.12.1993, banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal J312090080, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

3. Objekti i veprimtarisë

3.1 Objekti i veprimtarisë do të jetë:

"Shoqëria do të organizohet dhe funksionojë si një shoqëri HOLDING, me pjesëmarrje direkte ose indirekte në kapitalin tregtar të shoqërive të tjera tregtare, vendase ose të huaja. Në funksion dhe përmbushje të objektit të sipërcituar të aktivitetit, shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion të ligjshëm tregtar e financiar, duke përfshirë por pa u kufizuar në të drejtën e saj për të investuar në instrumente financiare, tituj pjesëmarrje në kapitale, tituj borxhi, aksione e kuota dhe/ose fonde investimesh. Shoqëria mund të blejë/shesë, të japë dhe të marrë me qira, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë".

3.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. Selia e shoqërisë

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Rruga "Abdyl Frasheri", EGT Tower, Pallati 17/6, Kati 2, Ap.1, Tiranë, Shqipëri.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të



-
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimitarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 200.000 (dyqind mijë lekë).
- Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale ALL 200.000 (dyqind mijë lekë) dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administrator i parë i shoqërisë është: **Z. Qazim Boja**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 09.12.1993 i identifikuar nga pasaporta me nr. BR4621111 dhe nr. personal J312090080.

9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.



ORTAKU I VETËM

Qazim Boja

QAZIM BOJA

[emër, mbiemër, firmë]

Datë 30.05.2022

Q